b. Të mbikëqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Bashkisë Shkoder dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas kontratës së nënshkruar dhe sipas, Ligjit Nr 8402, dt. 10.09.1998, Vendimin Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, U.K.M Nr.1, dt. 22.02.2005, U.K.M Nr 2, dt.13.5.2005.

- Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standardeve të përcaktuara me ligj.

Të paraqesë pranë Bashkisë Shkoder **stafin e tij mbikëqyrës** në përbërje të së cilit duhet të ketë:

4. **Mbikëqyrësin e materialeve dhe cilësisë** që duhet të jetë inxhinier **Ndërtimi** me licensën profesionale përkatëse, me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek e miraton cilësinë e punimeve, korespondencën me Bashkinë Shkodër, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.
 5. **Mbikëqyrësin për punimet elektrike (me kohë të pjesëshme)** që duhet të jetë inxhinier elektrik me licensën profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton punimet elektrike e objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.
 6. **Mbikëqyrësin për punimet topografike (me kohë të pjesëshme)** që duhet të jetë inxhinier topograf me licensën profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton punimet topografike të objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.
- Mbikëqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktuar me Bashkinë Shkodër, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin dhe probleme të ndryshme që mund të lindin gjatë zbatimit.

- Mbikëqyrësi vihet në dijeni nga Bashkia Shkodër për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontratën e nënshkruar.
- Mbikëqyrësi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet qeverisëse lokale ose qëndrore në juridiksionin e të cilit ndodhet zona e ndërtimit ku kryhen punimet e këtij objekti dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me nenin 9, të Ligjit Nr 8402, dt. 10.09.1998.
- Mbikëqyrësi në fillimin e punimeve së bashku me kontraktorin duhet të bëjë një inspektim të gjëndjes së rrugës ekzistuese duke bërë inventarin e plotë të të gjithë aseteve rrugore të cilat do hiqen dhe do magazinohen si dhe tjerat që do prishen.
- Mbikëqyrësi i punimeve në fillimin e punës do të marrë kontakt dhe me kompanitë e mirmbajtjes të kontraktuara nga Bashkia Shkodër apo entet tjera publike dhe të ndajë detyrat gjatë kohës së zhvillimit të punimeve në objektin e marrë në dorëzim.

Mbikëqyrësi ka për detyrë:

- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të liçensave të autorizimeve dhe të lejeve që sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
- Të njihet me hollësi me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit ***me të dhënat e më poshtme:***

Emërtimi i objekteve:

Sistemim Asfaltim rruga e varrezave të qytetit “Fshati Golem”, Bashkia Shkodër Data e marrjes së lejes së ndërtimit

Investitori: ***“Bashkia Shkodër”;***

Projektuesi “ ;

Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik..... sh.p.k;

Mbikëqyrësi i punimevesh.p.k;

Afati i ndërtimit të objektit.....;

Vlera e objektit.....Lekë (me TVSH);

3. Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese, të sigurisë, shiritave, fenerëve etj, sipas dokumentacionit të vlerësimit të rrezikut, (Vendimi, nr 312, dt .05.05.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe koordinimit)(PSK).
4. Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë Bashkisë Shkodër të gjithë dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:
 - Stafi i sipërmarrësit;
 - Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit;
 - Laboratori i liçensuar që do të kryhej testet e materialeve;
 - Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar;

-
- Të kontrollojë zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt- zbatimin dhe specififikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka, ti propozojë Bashkise Shkoder, zgjidhjet konkrete;
 - Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta duke dhënë udhëzime,porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse të kontratave;
 - Të kërkojë të zbatojë në mënyrë korrekte plan–organizimin e punimeve të objektit;
 - Të kërkojë dhe të zbatojë lejen(autorizimin,pëlqimin)mjedisore të miratuara nga organi kompetent;
 - Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme pikëtimin e objektit, kuotat e thellësisë së kanaleve dhe kuotat e vendosjes së veprave të artit;
 - Të respektojë dokumentacionin përkatës kur objekti ndërtohet në zonat turistike, arkeologjike apo të trashëgimisë kulturore;
 - Të kontrollojë bazamentin e objektit dhe të japë miratimin e tij për vazhdim të punimeve;
 - Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër dhe mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij;
 - Për çdo punim të dukshëm ose të padukshëm në të gjitha fazat e ndërtimit të bëjë fotografimin ose regjistrimin e tij dhe të mbajë proces-verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit;
 - Në fund të çdo dite pune të kontrollojë ditarin e punimeve dhe të firmosë atë;
 - Të kontrollojë situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në fazat e ndryshme të punimeve dhe miratojë ato;
 - Të kontrollojë librezën e masave ku pasqyrohen vëllimet metrike, gradualisht me zhvillimet e tyre;
 - Të kontrollojë certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të japë miratimin për vendosjen e tyre në objekt;
 - Të njoftojë sipërmarrësin për difektet e vëna re dhe kohën e korrigjimit të tyre;
Punimet me difekte nuk pranohen dhe nuk financohen deri në korrigjimin e tyre;
 - Gjatë zbatimit të projektit i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit sa herë që e shih të nevojshme dhe sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë nga mbikëqyrësi i punimeve;
 - Për çdo rast që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projekt-Preventivin e parashikuar, mbikqyrësi i punimeve duhet të paraqesë pranë Bashkise Shkoder, një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi i miratuar edhe nga projektuesi dhe më pas ky ndryshim do të zbatohet në objekt vetëm pas miratimit nga Bashkia Shkoder;
 - Të nënshkruajë aktin përfundimtar të kontrollit të punimeve për faza të ndryshme;
 - Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë Bashkise Shkoder raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve, pagesave të kryera, realizimin e punimeve në vleftë dhe % , afatin kohor e realizimin e financimit;

Raporti mujor do të ketë këtë përmbajtje:

-
- *Hyrje*
 - *Informacion i përgjithshëm*
 - *-Të përgjithshme;*
 - *-Qëllimi i punimeve;*
 - *-Mbikëqyrja e punimeve ndërtimore ;*
 - *Personeli i siguruar nga Mbikëqyrësi*
 - *-Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve;*
 - *-Stafi aktual;*
 - *-Kohë qëndrimi në objekt për secilin;*
 - *Raportimi*
 - *Kohë zgjatje e shërbimit të Mbikëqyrjes*
 - *Përshkrimi i Projektit*
 - *-Linjat e Ujësjiellit (linja shpërndarje) pusetat etj;*
 - *Organizimi i Sipërmarrësit*
 - *-Sipërmarrësi;*
 - *-Stafi prezent;*
 - *-Mjete dhe makineri;*
 - *-Kohë qëndrimi në objekt;*
 - *Progresi Mijor*
 - *Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave)*
 - *Fotografi të proçeseve të punëve të kryera*
 - *Fotografi të punimeve kryesore të dukshme ose të padukshme.*
 - *Grafiku i ecurisë së punimeve*
 - a - Të aprovuara;*
 - b - Të kryera;*
 - *Volumet Progresive të Punimeve Mijore*
 - a - Punimet e Aprovuara;*
 - b - Çertifikatat e cilësisë dhe testet Laboratorike;*
 - c - Libreza e Masave;*
 - d - Punimet e Kryera por të pa aprovuara;*
 - e - Situacionet mijore;*
 - f- Matjet topografike*
 - *Korespondenca*
 - *Proçes – verbale;*
 - *Urdhëresa, Udhëzime, Njoftime;*
 - *Ndryshime në Projekt dhe Preventiv në se ka (të aprovuara nga A.K.U.K-ja);*
 - *Moti (kalendarik)*
 - *Problemet që kanë dalë*
 - c- Teknike;*
 - d- Sociale;*
 - *Konkluzione*

Shënim: Raporti mujor dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pesë kopje dhe tre kopje, të dorëzohet në Bashkinë Shkodër, pranë **Sektorit të Ndjekjes së Investimeve** në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, personit që ndjek zbatimin e kontratës në emër të investitorit Bashkia Shkoder.

Raporti mujor do t'i dorëzohet Bashkisë Shkodër brenda datës të caktuar në kontratë.

Mbikëqyrësi do të mbajë kontakte të vazhdueshme me Bashkinë Shkodër (Sektorit të Ndjekjes së Investimeve në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit personit që ndjek zbatimin e kontratës në emër të investitorit Bashkia Shkoder) dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.

Mbikëqyrësi mban përgjegjësi të plotë:

Mbikëqyrësi i punimeve është përgjegjësi kryesor për zbatimin e objektit.

Me fillimin e punimeve mbikëqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e objektit si më poshtë vijon:

1. Vendimin e **lejes së ndërtimit**;
2. Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike;
3. Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet;
4. Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike;
5. Saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit;
6. Për realizimin pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe Bashkisë Shkodër, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit;
7. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit. Sipërmarrësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij;
8. E gjithë korespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me investitorin dhe me sipërmarrësin përbën dokumentacionin e plotë të objektit dhe si e tillë ruhet me çdo kusht ku pasqyrohen të gjitha aktet, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontraditat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme.
9. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve të mbahet proces-verbali i dorëzimit të punimeve, ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri.
10. Bashkia Shkodër kontrollon praninë e mbikëqyrësit të punimeve në objekt dhe në rast konstatimi të mungesës së tij nxjerr vendimin për pezullimin e punimeve deri në emërimin dhe praninë e tij në objekt;

Mbikëqyrësi ka të drejtë:

- Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë në punë;
- Të mos pranojë drejtues teknik , manovrator, punëtor, n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar;
- Të pezullojë punimet kur shihet se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun;

-
- Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe të zëvendësojë ato me materiale të tjera nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij;
 - Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve;
 - Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit;
 - Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurt dhe cilësore;
 - Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike;
 - Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi këto duhet të dokumentohen me proces-verbalet e analizave të provave së bashku me aktin teknik ku të argumentohen shmangiet e palejuara ,referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit;
 - Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit;
 - Të kërkojë kryerjen e provave me ngarkesë ose pa ngarkesë sipas Standarteve Shqipëtare të miratuara nga Drejtoria Përgjithshme e Standartizimeve, K.T.P apo K.T.Z në fuqi për tubacionet e vendosura në objekt;
 - Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka dëmtime të rënda, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
 - Mbikëqyrësi i punimeve urdhëron sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt-zbatimin ose në Specifikimet Teknike;
 - Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e Bashkisë Shkoder për atë kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas fajit, mbikëqyrësi së bashku me Bashkinë Shkoder dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit të punimeve dhe të ndryshimit të shpenzimeve.
 - Mbikëqyrësi duhet të firmosë gjithë dokumentacionin që ka miratuar, ai mban përgjegjësi ligjore së bashku me sipërmarrësin. Një kopje e dokumentacionit të miratuar nga mbikëqyrësi i dorëzohet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit të objektit.
 - Mbikëqyrësi merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës si dhe firmos proces-verbalin e kolaudimit;
 - Mbikëqyrësi kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht Bashkisë Shkoder për gjëndjen e tij në rast se Bashkia Shkoder ka vërejtje e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet midis tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

Në përfundim të punimeve mbikëqyrësi:

- Mbikëqyrësi me kërkesë të sipërmarrësit vërteton në proces-verbal datën e përfundimit të punimeve sipas projektit, kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara në kushtet e kontratës dhe brënda 30 ditëve merr prej tij dokumentacionin përkatës.
- Duke u mbështetur në Ligjin 8402, dt. 10.09.1998, U.K.M Nr 2, dt. 13.5.2005 dhe Vendimin Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet

e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve, dorëzon pranë A.K.U.K-së(Sektorit të Ndjekjes së Investimeve) të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin saktësinë dhe vërtetësinë e tij.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë:

1. Proçes-verbalin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit;
2. Proçes-verbalin për fillimin e punimeve;
3. Kontratën e sipërmarrësit;
4. Kontratën e mbikëqyrjes së punimeve;
5. Projekt organizimin e punimeve;
6. Projekt-Zbatimin;
7. Projekt-Zbatimin e ndryshuar(nëse ka) shoqëruar me korespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme;
8. Preventivin me vlerën fituese në tender;
9. Preventivin e ndryshuar (nëse ka zëra të rinj të punimeve, negocimin e tyre);
10. Grafiku i punimeve;
11. Specifikimet teknike;
12. Azhurnimi para fillimit të punimeve dhe pikëtimi i objektit;
13. Dokumentacioni topografik dhe gjeologo inxhinierik;
14. Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi për punimet e dukshme dhe të padukshme;
15. Proçes-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi i punimeve të shoqëruar me fotografitë përkatëse;
16. Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi;
17. Libreza e masave;
18. Shkresën e mbikëqyrësit , për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezerve shoqëruar me dokumentacionin përkatës;
19. Proçes- verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi,(drejtuesi teknik)dhe mbikëqyrësi i punimeve;
20. Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarrësi(drejtusi teknik) dhe mbikëqyrësi i punimeve;
21. Situacioni i fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi(drejtusi teknik) dhe mbikëqyrësi i punimeve.
22. Çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe testet laboratorike të materialeve të përdorur në objekt;
23. Miratimi i materialeve të përdorura nga mbikëqyrësi i punimeve;
24. Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar;
25. Regjistri i kontabilitetit të shpenzimeve;
26. Deklarata teknike e sipërmarrësit e firmosur nga sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik;
27. Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve;
28. Dokumentin e vlerësimit të rrezikut sipas Vendimit Nr.312 dt. 05.05.2010 i Këshillit të

- a. Ministrave “Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe Koordinimit (PSK);

-
29. Procesverbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar;
 30. Relacionin përfundimtar i mbikëqyrësit të punimeve;

(Formatet tip të dokumentacionit të jenë sipas formatit tip, në Vendimin Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve. I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e mbikëqyrësit të punimeve.

Ky dokumentacion është në 3(tre) kopje. Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë kolaudatorit ose grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër të Bashkisë Shkodër brënda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve në objekt.

Të gjitha dokumentat që dorëzohen tek kolaudatori ose në grupin e kolaudimit pranë Bashkisë Shkodër duhet të jenë **origjinale**.

- Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet grupit të kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos Procesverbalin e kolaudimit.
- Mbas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe dokumentacionin tjetër përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për likujdim Bashkisë Shkodër.

V - KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES.

Do të jetë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve deri në përfundimin e objektit (përfshirë dhe zgjatjen e afatit të kontratës së sipërmarrësit).

Bashkia Shkodër ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikëqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara;
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre;
- Mangësi kontrolli në koston e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike;

Kur konstatohen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Bashkia Shkodër ka të drejtë të urdhërojë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjëndjes.

Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative vendosen sanksione në bazë të neneve 15 dhe 16, të kreut III, të ligjit Nr 8402, dt.10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

VI. MËNYRA E PAGESËS

Pagesa do të bëhet në përfundimin e realizimit të punimeve të zbatimit.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të konkretisht **140,728** (njëqind e dyzetmijë e shtatëqind e njëzet e tetë) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të

gjitha vendet ku operatori ka ushtruar aktivitet për vitin e **fundit (këstet e maturuara)** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet e kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **70,364 (shtatëdhjetë mijë e treqind e gjatëdhjetë e katër)** lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për “**Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) ose Kontrata bashkëpunimi të vlefshme me shoqëri ose inxhinierë të liçensuar për këto kategori:

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime..”

Kategoria NP-7 Niveli A “Ujesjellesa ,gazsjellesa,vajsjellesa,...”

Kategoria NP-11 Niveli A “Ndërtim N/Stacionet, kabinat e transformatoreve”

Punime speciale ndërtimi:

Kategoria NS-6 Niveli A “Sinjalistike rrugore jo ndriçuese”

Kategoria NS-8 Niveli A “Ndërtim parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”..

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për

licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 1 (nje)inxhinier ndertimi
- 1 (nje) inxhinier topograf
- 1 (nje) inxhinier elektrik

Inxhinieret e mësipërm duhet të jetë i licensuar per kategorite e kerkuara, të vërtetuar me Licence profesionale te shoqerise ose Licence individuale, kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per te pakten muajin e fundit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.4 Një punësim mesatar i te punësuarve prej të paktën **5 (pesë)** personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për kete muaj.
- b) Listpagesa e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per periudhen e mesiperme.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

a. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të konkretisht **71,612** (shtatëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të

gjitha vendet ku operatori ka ushtruar aktivitet për vitin e fundit (këstet e maturuara) (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet e kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **70,364 (shtatëdhjetë mijë e treqind e gjatëdhjetë e katër) lekë.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

b. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.

c. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për “**Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) ose Kontrata bashkëpunimi të vlefshme me shoqëri ose inxhinierë të liçensuar për këto kategori:

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime..”

Kategoria NP-7 Niveli A “Ujesjellesa ,gazsjellesa,vajsjellesa,...”

Punime speciale ndërtimi:

Kategoria NS-6 Niveli A “Sinjalistike rrugore jo ndriçuese”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”..

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për liçencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për

“Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

1 (nje)inxhinier ndertimi

1 (nje) inxhinier topograf

Inxhinieret e mësipërm duhet të jetë i licensuar per kategorite e kerkuara, të vërtetuar me Licence profesionale te shoqerise ose Licence individuale, kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per te pakten muajin e fundit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.4 Një punësim mesatar i te punesuarve prej të paktën **5 (pesë)** personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

b. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

